



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Nr. Prot. 1225

Tiranë, më 25.02, 2021

KONTRATË

Sot më datë 25.02.2021, është lidhur kjo kontratë, midis palëve të mëposhtme (këtu e në vijim referuar si “Kontrata”):


Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me numër unik identifikimi (NIPT) K72301452S, me seli në adresën Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Tiranë, e përfaqësuar në këtë Kontratë nga Drejtor i Përgjithshëm Znj. Mirlinda Karçanaj, këtu e në vijim referuar si “**Autoriteti Kontraktor**” ose “**Porositësi**” nga njëra anë,

dhe

“**BNT Electronics**” SH.P.K themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me numër unik identifikimi (NIPT) J61817047D, me adresë Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë, përfaqësuar në këtë Kontratë nga **Z. Jovan Bojdani**, që më poshtë do të quhet “**Kontraktori**” ose “**Ofruesi i Shërbimit**”, nga ana tjetër.

Porositësi/Autoriteti Kontraktor dhe Ofruesi i Shërbimit/Kontraktori referohen këtu e në vijim bashkërisht si “Palët”, ose veçmas si “Pala”.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9643 dt. 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM Nr. 914 dt. 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Kod Civil i Republikës së Shqipërisë, Kreu II pika 5/j e VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar.



Adresa:
Rruga “PAPA GJON PALI II”
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SHËRBIME TENDER I HAPUR

Neni 1 Objekti

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Kontraktuesi merr përsipër realizimin e kontratës me objekt:

“Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga republika e Shqipërisë”, për Agjencinë Kombëtare të Diasporës

Neni 2 Vlera e Kontratës

Vlera totale e kontratës është:

17,612,000 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

- Vlera e implementimit : 12,428,000 (dymbëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e tetë mijë) lekë pa TVSH
- Vlera e mirëmbajtjes : 5,184,000 (pesë milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH

Ose

21,134,400 (njëzetë e një milion e njëqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind) lekë me TVSH

- Vlera e Implementimit: 14,913,600 (katërmëdhjetë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë me TVSH
- Vlera e mirëmbajtjes: 6,220,800 (gjashtë milion e dyqind e njëzetë mijë e tetëqind) lekë me TVSH



Adresa:
Rruga “PAPA GJON PALMI”
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 3

Kohëzgjatja e Kontratës

Zbatimi i kontratës do të fillojë me lidhjen e kontratës dhe do të vazhdojë për 2 (dy) muaj implementim dhe 48 (dyzetë e tetë) muaj mirëmbajtje.

Neni 4

Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5

Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtim ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6

Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet



Adresë:
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7

Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështeti dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 8

Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit


- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Oferta teknike.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.



Adresa:
Rruga "PAPAGJON PAJII"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764



- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 9 Specifikime dhe Skicime

- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatiti të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysht standartet më të fundit.
- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjënjëse përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 10 Lejet dhe Liçensat

- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.
- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

- 11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.



Adresa:
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 12 Vendndodhja

- 12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.
- 12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 14 Çmimi i Kontratës

- 14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 15 Afatet e Pagesës

- 15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

- 15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer

Adresa:
Rruga "PAPA GJON PALMI"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@aksh.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

15.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16

Vonesa në Bërjen e Pagesës

16.1 Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Neni 17

Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

17.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 18

Forca Madhore

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.



Adresë:
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,

Email: info@aksh.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 19

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likujdojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 20

Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.



Adresat
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 21

Negociatat dhe Amendamentet

- 21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 22

Ndryshimi i Porosisë

- 22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 23

Ndërprerja për Mosplotësim

- 23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 24

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.
- 24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.



Adresa:
Rruga "PAPA GJON PALINI"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@eksh.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik:

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohej të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 26 Nënkontrata

26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

26.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejte të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nënkontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të japë me nënsipermarrje.

26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 27 Transferimi i të Drejtave

Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.



Adresa
Rruga "PAPA GJON PALII"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@aksht.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 28

Sigurimi i Kontrates

- 28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.
- 28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 29

Baza Ligjore

- 29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 30



Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.


Neni 31

Përfaqësimi i Palëve

- 31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.



Adresa:
Rruga "PAPA GJON PALINI"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@aksu.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 32
Lajmërimet

32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 33
Llogaritja e Afateve

33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndrysh




Adresa:
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

SHËRBIMET – PROCEDURË E HAPUR

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do të mbizoterojnë ato të Kushteve të veçanta të kontratës.

Neni 1 Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është **Agjencia Kombëtare e Shoqërisë Informatike**
- 1.2 Kontraktuesi është **“BNT Electronics” Sh.p.k**
- 1.3 Përfituesi i shërbimit është : **Agjencia Kombëtare e Diasporës**

Neni 2 Sigurimi i kontrates

- 2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:
Me përfundimin e kontratës të shoqëruar me shkresë zyrtare, e cila do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e përfundimit të kohëzgjatjes së Kontrates.

Neni 3 Fillimi i Kontrates

- 3.1 Zbatimi i kontratës do të fillojë me lidhjen e kontratës dhe do të vazhdojë për 2 (dy) muaj implementim dhe 48 (dyzetë e tetë) muaj mirëmbajtje.

Adresa:
Rruga “PAPA GJON PALI II”
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

3.2 Personat e autorizuar për ndjekjen e Kontratës:

- Për **Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)**:

- Për **“BNT Electronics” sh.p.k**

z. Florjan Vrenezi
znj. Melisa Dauti
znj. Xhuljana Beca
z. Florian Tani

Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve

4.1 Shërbimet do të kryhen sipas përcaktimeve në ofertën teknike.

Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:
Një kopje të databazës në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

Neni 6 Kërkesat e Raportimit

6.1 Gjatë zbatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raportime për Autoritetin Kontraktor sipas formulimit të mëposhtëm: Raportet do të dërgohen sipas përcaktimeve të Ofertes Teknike bashkëlidhur kontratës.



Adresë:
Rruga “PAPA GJON PALI II”
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 7

Siguracioni i Përgjegjesisë Profesionale

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: Referuar Nenit 2.

Neni 8

Kushtet e Pagesës

8.1 Pagesa do të kryhet në bazë të çdo fature tatimore të paraqitur nga kontraktuesi për pjesën e shërbimeve/produkteve që i takon sipas ofertës, me këto të dhëna si më poshtë:

Të dhënat e pagesit të shërbimit në emer të të cilit do të lëshohen faturat tatimore:

Agjencia Kombëtare e Diasporës

Të dhënat e përfituesit të shërbimit: **Agjencia Kombëtare e Diasporës**

Të dhënat e llogarisë së Kontraktuesit :

Banka: ~~Credit~~

Nr. i llogarisë : ALL [REDACTED]

Iban: AL90 2512 0160 0005 0000 0048

8.3 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda 30 ditëve nga data e çdo faturimi për shërbimet/produktet përkatëse të realizuara nga secili Kontraktues.

8.4 Monedha e pagesës do të jetë monedha Shqiptare.

Neni 9

Adresa:

Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Pagesa Paraprake

- 9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë.....Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.
- 9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme:

Neni 10 Pranimi i shërbimeve

- 10.1 Në përfundim të çdo levrimi shërbimi/pune, por jo më vonë se 3 ditë nga data e çdo levrimi, përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit (përcaktuar në Nenin 3.2 KVK) do të kryejnë pranimin e shërbimeve/punëve të kryera dhe dorëzuara nga Kontraktuesi.
- 10.2 Pranimi do të kryhet nëpërmjet testimeve të pranimi. Përfundimet e testimeve të pranimi do të dokumentohen në formë të shkruar dhe do të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit dhe Kontraktuesi. Në rast se brenda afatit të pranimi do të kërkohej nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit që të behen ndryshime në shërbim, atëherë pranimi i testimit për ato elemente shërbimi që janë kërkuar të ndryshohen, do të ribehet pasi të jete aprovuar ndryshimi dhe prezantimi i tij. Testimi i pranimi do të kryhet si më poshtë:
- a) Kontraktuesi do të njoftojë përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit 3 ditë pune përpara datës së fillimit të testimit që është gati të fillojnë testimet e pranimi dhe do të ofrojë propozimet për skenarët e testimit dhe për të dhënat e testimit.
- b) Kontraktuesi do të kryejë instalimet e dorëzimeve në mjedisin test
- c) Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit në bashkëpunim me Kontraktuesin, do të përcaktojnë kohëzgjatjen e testimit të pranimi, por në çdo rast, ajo nuk do të jetë më shumë sesa 3 ditë pune nga data e instalimit të dorëzimeve.
- d) Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit do të zhvillojnë testimet e pranimi duke ndjekur skenarët e testimit. Kontraktuesi do të jetë i pranishëm gjatë zhvillimit të testimit nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit.
- e) Testimi i pranimi do të dokumentohet në protokollin e pranimi, duke dalluar qartë rezultatin e testimit (me sukses, pjesërisht me sukses, pa sukses) dhe duke evidencuar gjetje ose komente. Protokollin e pranimi do të nënshkruhet nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit dhe Kontraktuesi.



Adresë
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

- f) Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit duhet të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për pranimit ose jo të dorëzimeve për të cilat u realizua testimi i pranimit jo më vonë sesa 3 ditë pune nga data e realizimit të testimit të pranimit.
- 10.3 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit gjykon që dorëzimet nuk janë të pranueshme, atëherë ai duhet ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin menjëherë pas kryerjes së testimit të pranimit dhe të specifikojë arsyet e mospranimit të dorëzimeve. Dorëzimet do të quhen të pranuar në çdo rast, përveçse kur Autoriteti Kontraktor identifikon tek to mangësi të tilla që:
- a) Pëngojnë funksionimin e komponentëve objekt të kësaj kontrate nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit, apo palë të tjera të përfshira.
 - b) shkaktjnë kufizime në realizimin e funksioneve të rëndësishme të komponentëve objekt të kësaj kontrate, të tilla që nuk mund të zgjidhen brenda një intervali të arsyeshëm kohe.
 - c) janë zgjidhje provizore që mundesojnë funksionimin e shërbimit por që nuk janë konform standarteve teknike apo pengojnë rihvillimin në kohe të mëvonshme.
 - d) Performanca funksionaliteteve është e ulët dhe e padobishme për institucionin përfitues.
- Kontraktuesi duhet të zgjidhë çdo mangësi që mund të jetë evidentuar nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit në protokollet e pranimit.
- Nëse ndonjë nga testimet e pranimit nuk është realizuar brenda 3 ditë pune nga data e instalimit të dorëzimeve, ose nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit nuk kanë njoftuar që dorëzimet janë të papranuara brenda afatit të përcaktuar (3 ditë pas kryerjes së testimit të pranimit), atëherë dorëzimet do të konsiderohen të pranuar.
- 10.4 Kontraktuesi do të njoftojë përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesit të shërbimit 1 ditë para për gadishmërinë e lëvrimeve të produkteve. Çdo furnizim do të shoqërohet me faturën tatimore të shitjes si dhe me Akt Dorëzimin, i cili do të nënshkruhet nga përfaqësuesit e palëve. Brenda 3 ditësh nga data e çdo dorëzimi, Autoriteti Kontraktor do të nënshkruajë proces-verbalin e pranimit të çdo parti produktesh.

Neni 11 Zbritja e garancisë së kontratës

- 11.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë:
Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.



Adresa:
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Neni 12
Te Ndryshme

12.1 Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

12.2 Kjo Kontratë hartohet në 4 (katër) kopje, ku 3 (tre) kopje janë për Autoritetin Kontraktor dhe 1 (një) kopje për Kontraktorin. Çdo kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.

Kësaj Kontrate i bashkëngjitet:
Aneksi 1 – Specifikimet Teknike.
Formulari i Ofertës.

Autoriteti Kontraktor

Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së
Informacionit (AKSHI)

Mirlinda KARÇANAJ



Kontraktuesi

"BNT Electronics" Sh.p.k

Jovan BOJDANI



Koncepti: M. Dobi

D: Gjylke

Adresa:
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Shtojca 1**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Data: 18/12/2020

Emri i Ofertuesit: BNT Electronics

Për: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

"Rruga Papa Gjon Pali II", Nr.3, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozime

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga republika e Shqipërisë- për Agjencinë Kombëtare të Diasporës"

Publikimi 25/11/2020: Buletini i Njoftimeve Publike [01/12/2020] [Nr 111]/Nr.Referencës në faqen e APP-së REF-79738-11-24-2020

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruar, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është **17,612,000 (shtatembdhjete million e gjashtëqind e dymbdhjete mije) Lek pa TVSH;**
2. Çmimi total i ofertës sonë është **21,134,400 (njetete e nje million e njeqind e tridhjetë e kater mije e katerqind) Lek me TVSH**

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1	Zhvillimi i sistemit informatik	1	12,100,000	12,100,000
2	Trajnime (ne jave)	1	328,000	328,000
3	Mirëmbajtje (ne muaj)	48	108,000	5,184,000
TOTALI PA TVSH (LEKË)				17,612,000
TVSH				3,522,400
TOTALI ME TVSH (LEKE)				21,134,400

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 2 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje nga nënshkrimi i kontratës.

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Leke (kërkuar në dokumentat e tenderit)

Përfaqësuesi i ofertuesit**Jovan Bojdani****Nënshkrimi****Vula**

BNT ELECTRONICS

Blv "Zhan D'ark". Kulla III, Kati II, Tiranë
e-mail: info@bntelectronics.com

Fila 1 nga 1

Nr i Llogarisë : 00120 SOCIETE GENERALE ALBANIA, Dega
Tiranë
Kodi Fiskal 3704240
NIPT: J61817047DTEL: + 355 4 273666
FAX: +355 4 273777

Oferte Teknike

Date:18.12.2020

Drejtuar: AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

BNT ELECTRONICS

**"KRIJIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË STUDENTËVE TË CILËT
STUDIOJNË JASHTË VENDIT,
DHE SHTETASVE TË HUAJ ME ORIGINË SHQIPTARE,
TË CILËT PËRFITOJNË BURSA NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË"**

BNT Electronics, Dhjetor 2020

BNT ELECTRONICS

Blv "Zhan D'ark" Kulla III, Kati II, Tiranë

e-mail:info@bntelectronics.com

Faqja 1 nga 18

Nr i Llogarisë : 00120 SOCIETE GENERALE ALBANIA, Dega

Tiranë

Kodi Fiskal 3704240

NIPT: J618170470

TEL: + 355 4 273666

FAX: +355 4 273777

1. HYRJE**1.1. Përfituesi / Autoriteti Kontraktues**

Përfituesi: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Ministri i Shtetit për Diasporën

Autoriteti Kontraktues: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

1.2. Historiku

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet: a) përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, aty ku gjendet; b) ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare; c) nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës; d) bashkëpunimit për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

1.3. Situata Aktuale në Sektor

Vlerësimi i rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, realizohet nga një komision i veçantë me 9 (nëntë) anëtarë, nga institucionet përgjegjëse, i cili ngrihet me urdhër të Kryeministrit. Ai drejtohet nga ministri përgjegjës për diasporën. Komisioni realizon një raport vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nën komisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë. Dhënia e bursave shtetasve të huaj me origjinë shqiptare bëhet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe rregullohet me akte të tjera.

Shtetasit shqiptarë dhe ato me origjinë nga Shqipëria, prej disa vitesh përfitojnë mbështetje financiare për realizimin e studimeve universitare jashtë vendit. Kjo mbështetje, ofrohet e plotë dhe/ose e pjesshme përmes disa programeve dhe incentivave finaciare, të tilla si:

- Programi i Ekselencës,
- Bursat e studimit (të plota/pjesshme) të ofruara nga Qeveritë e vendeve të ndryshme, në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe me Republikën e Shqipërisë,
- Programeve të ndryshme ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Aktualisht procedurat bëhen me letër dhe nuk ka një databazë të qendëruar, gjë që sjell probleme në menaxhim, vonesa gjatë proceseve të punës dhe vështirësi në analizimin dhe përpunimin e informacionit.

Nevoja për krijimin e një baze të dhënash shtetërore elektronike të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga



Republika e Shqipërisë, ka të bëjë me aspektin e mirë organizimit të punës, efikasitetit dhe rritjes së produktivitetit me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj shtetasve të interesuar. Nga ana tjetër, në aspektin menaxherial, krijimi i një baze të qëndrueshme të dhënash do të ndikonte në përmirësimin e mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave, gjë që do të fokusonte orientimin e politikave të institucionit në kuadër të një vendimmarrje efikase.

Referuar sa më sipër si dhe në mbështetje të VKM Nr. 504, datë 24.06.2020 " Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë" nëpërmjet kësaj kontrate synohet krijimi të një baze të dhënash shtetërore që do të mundësojë:

- Regjistrimin e të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.
- Aksesi në databazë për të gjitha institucionet e interesuara.
- Gjenerimin e raporteve të detajuara statistikore.
- Ruajtje e historikut për veprimet e kryera në sistem.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1.Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit është zhvillimi i nje sistemi informatik per automatizimin e procedures se perfitimit te bursave te studimit nga Republika e Shqiperise, i cili në zbatim të politikave të institucionit do të përmirësojë procesin e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë;

2.2.Qëllimi



Qëllimet e këtij projekti janë si më poshtë:

- Automatizimi i procesit të regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë;
- Krijimi i një baze të dhënash me të gjithë fushat e nevojshme për ruajtjen e gjithë informacionit.
- Përmirësimi i cilësisë së punës brenda institucionit në procesin e hedhjes, ruajtjes, dhe përpunimit të të dhënave. Sigurimi i një komunikimi të mirë dhe informim në kohë reale duke ndjekur në mënyrë të automatizuar të gjithë procesin.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e VKM Nr. 504, datë 24.06.2020 " Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë"

2.3.Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori

Rezultatet e pritshme që do të arrihen nga BNT Electronics në kuadër të këtij projekti janë:

- Zhvillimi i një sistemi informatik për automatizimin e procedurës së përfitimit të bursave të studimit nga Republika e Shqipërisë i cili në zbatim të politikave të institucionit do të përmirësojë procesin e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë;
- Trajnimi për përdorimin e sistemit;
- Procesi i mirëmbajtjes.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1.Supozimet e Projektit

Realizimi i këtij projekti bëhet nën supozimet:

- Kontraktorit do t'i vihet në dispozicion çdo informacion që ka lidhje me procedurën e përfitimit të bursave të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare;
- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti;

BNT ELECTRONICS

Blv "Zhan D'ark" Kulla III, Kati II, Tiranë
e-mail: info@bntelectronics.com

Faqja 4 nga 18

Nr i Llogarisë : 00120 SOCIETE GENERALE ALBANIA, Dega
Tiranë
Kodi Fiskal 3704240
NIPT: J61817047D

- Stafi i autoriteti kontraktues, përfituesit dhe operatorit ekonomik fitues duhet të jenë komunikues dhe bashkëpunues me njëri tjetrin;
- Angazhim dhe mbështetje e plotë nga të gjithë aktorët të përfshirë në këtë projekt;

3.2. Risqet

Faktorët kufizues që rrezikojnë implementimin e projektit mund të jenë:

- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e mos koordinimit të punës mes pjesëtarëve të përfshirë në këtë proces;
- Eksperienca e stafeve që do të përfshihen në realizimin e projektit.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është si më poshtë:

- Ligji nr. 115/2017, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës"
- VKM Nr. 504, datë 24.06.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë"
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore"
- Vendimi nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore", në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.
- Ligji Nr. 9887, Datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

4.1.1 Përshkrimi i detyrës

Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, do të realizohet zhvillimi i nje sistemi informatik per automatizimin e procedures se perfitimit te bursave te studimit nga Republika e Shqiperise i cili në zbatim të politikave të institucionit do të përmirësojë procesin e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të të gjithë të dhënave të nevojshme të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë

me qëllim përmirësimit e procedurave të punës së strukturave kompetente në Institucion dhe institucioneve të interesuara.

Permes ketij sistemi do të organizohen dhe mbledhen të dhënat në një bazë të dhënash shtetërore duke ndikuar pozitivisht në funksion të rritjes së performancës në funksion të monitorimit, mirëmenaxhimit dhe organizimit më të mirë të proceseve të punës.

Zhvillimi i ketij sistemi do të bazohet në një zgjidhje web, e centralizuar.

4.1.2 Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Republika e Shqipërisë dhe Diaspora.

4.1.3 Grupet e synuara

- Agjencia Kombëtare e Diasporës
- Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinise
- Shtetasit shqiptarë, të cilët kryejnë studimet universitare jashtë vendit;
- Shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë.
- Shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

4.1.4 Siguria e sistemit

Sistemi do të ketë nivele të ndryshme aksesit sipas rolit (RBAC) duke mbajtur parasysh konfidencialitetin për të dhënat që klasifikohen si të tilla. Veçoritë dhe karakteristikat për çdo përdorues do të specifikohen gjatë fazës së analizës.

Siguria do të ofrohet në disa forma dhe nivele për të mbrojtur informacionin dhe për të lejuar akses përdoruesve sipas parimit "jo më shumë se çfarë nevojitet".

Rolet dhe të drejtat e aksesit për secilin rol do të jenë të menaxhueshme nga administratori i sistemit nëpërmjet ndërfaqes së përdoruesit.

Akseset duhet të organizohen në formën e roleve për përdoruesve, të drejtave dhe relacioneve mes tyre. Rolet dhe përdoruesit, relacionet mes tyre dhe konfigurimi i të drejtave për role të ndryshme, janë dinamike dhe si rrjedhim objekt ndryshimi.



Është e rëndësishme që çdo ndryshim lidhur me të drejtat do të pasqyrojë efekt të menjëhershëm në sistem.

Sistemi nuk duhet te lejoje krijimin e llogarive pa fjalëkalim. Fjalëkalimet duhet te jene mbi 8 karaktere dhe te komplikuar, duke përdorur germa te mëdha, te vogla, numrat dhe simbole.

Çdo veprim në sistem do të duhet të regjistrohet (logs) duke përcaktuar qartë përdoruesin, kohën e veprimit (timestamp), llojin e veprimit (lexim, ndryshim, përditesim), të dhenat e ndryshuara, IP e përdoruesit etj.

Sistemi do të përmbajë mekanizma për audit të detajuar mbi fusha të caktuara në databazë, në formatin "ishte - u bë" kur ndryshohen vlera sensitive (shtim, modifikim, fshirje).

Log-et do të mbahen në mënyrë të sigurtë, për të mos lejuar aksesimin e paautorizuar të tyre, aq me tepër manipulimin e tyre.

Sistemi do të ofrojë nderfaqjen respektive për paraqitjen e log-eve si dhe mundësi për filtrimin e tyre, për gjetjen e shpejtë të gjurmëve që kërkohen dhe pamundësi të modifikimit të tyre.

Sipas nevojës, sistemi do të ofrojë mundësi gjurmimi për arsye auditi edhe të objekteve të databazës për veprime që manipulojnë informacionin: krijim, modifikim dhe fshirje. Do të mbahen loge mbi llojin e veprimit, objekti i cili i nënshtrohet këtij veprimi, vlerat e fushave të tij (si ishin, si u benë), atje ku kjo logjike aplikohet.

Sistemi do të përmbajë mekanizma për back up periodik të bazës së të dhënave, sipas praktikave më të mira duke përdorur me ekonomicitet burimet e sistemit, por dhe duke garantuar ruajtjen e të dhënave në një ambient të ndryshëm nga ai i prodhimit dhe rikthimin në punë.

Përcaktimi i nivelit të sigorisë, si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore, do te jete: M-D2I2K2.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
☐ D0	☐ I0	☐ K0	
☐ D1	☐ I1	☐ K1	☐ U
☒ D2	☒ I2	☒ K2	☒ M
☐ D3	☐ I3		☐ L

- Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.
- Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmëria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.



- Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm

4.2.Detyrat specifike

Projekti, gjate implementimit do te kaloje ne disa faza, si meposhtë:

FAZA I: Faza përgatitore për sistemin

Kjo fazë fillon menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe në të do të bëhet analizë e plotë e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore, proceset ekzistuese të mbajtjes së të dhënave, së bashku me kërkesat e sistemit;

FAZA II: Zhvillimi i sistemit

- Zhvillimi i sistemit informatik sipas kërkesave;

FAZA III: Testimi

- Plani i testimit duhet të përmbajë skenare të detajuar testimi, si edhe përcakton testuesit, aktivitetin e testimit, kriteret e pranimit dhe marrjes në dorëzim.
- Korrigjimi i bugs të raportuara
- Hapja e profileve të përdoruesve dhe popullimi me të dhenat fillestare

FAZA IV: Trajnimi i Përdoruesve të Sistemit

Organizim i trajnimeve për përdoruesit fundore dhe administratorët teknike të sistemit

FAZA V: Marrja në dorëzimi i sistemit

Pasi të gjithë modulet e sistemit të jenë testuar, do të bëhet dorëzimi final i sistemit. Në dorëzimin final do të përfshihen kodi burim, të gjithë komponentet e tjerë software, dokumentimi i konfigurimeve përkatëse dhe manualët e përdoruesve.

FAZA VI: Mirëmbajtje

Mirëmbajtje e sistemit sipas dispozitave të VLM- së Nr. 710 datë 21/07/2013, "Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit", do te jete për një periudhë 4 vjeçare.



5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Sistemi që do të implementohet, do të hostohet ne servera virtuale ne Datacenterin Qeveritar, pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

5.2.Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës, dhe periudha e implementimit të detyrave do të jetë 2 muaj nga kjo date dhe 4 vjet mirëmbajtja.

6. RAPORTIMI

6.1.Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip, në origjinal dhe ne dy kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet brenda një jave, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të perbehet prej 15 faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 10 dite para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njejtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 5 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2.Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEMI TË TIJERA

Sistemi do të jetë në gjendje të ekspozojë të dhëna në përputhje me standardet e përdorura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (Government Gateway) nëpërmjet ESB-së (Enterprise

Service Bus), si dhe të mund të presë të dhëna të sistemeve të tjera elektronike kur ato mundësohen nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.

Ky sistem do të ketë komunikim me:

➤ *Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile*

▪Parametër hyrës: NID

▪Parametër dalës të jenë:

- o Emër
- o Mbiemër
- o Atësia
- o Gjinia
- o Adresa
- o Datëlindja
- o Vendlindja

Përveç ndërveprimit të cilësuar më sipër, pjesë e këtij projekti është dhe implementimi i webservice-ve të reja që mund të dalin si kërkesa të reja gjatë fazës së analizës së procesit.

8. GARANCIA

Zgjidhja e ofruar duhet të ketë një garanci minimale prej 1 (një) viti.

9. MIRËMBAJTJA

Bazuar në VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit", periudha e mirëmbajtjes do të jetë 4 vjet.

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofroje shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë:

(a) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha pjeset e këtij projekti. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.

BNT ELECTRONICS

Blv "Zhan D'ark" Kulla III, Kati II, Tiranë
e-mail: info@bntelectronics.com



Faqja 10 nga 18

Nr i Llogarisë : 00120 SOCIETE GENERALE ALBANIA, Dega

TEL: + 355 4 273666

FAX: +355 4 273777

Tiranë

Kodi Fiskal 3704240

NIPT: J61817047D

(b) Shërbime Riparimi në vendndodhje. Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë interval kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik pergjegjes dhe të rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet që nuk i përkasin "Alarmeve Madhore", duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Autoriteti Kontraktor do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Operatori ekonomik duhet të kontaktojë stafin pergjegjes dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 10 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, personeli i autorizuar do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet Informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting shkakun e Alarmit madhor, atëherë ai duhet të dërgojnë një Teknik Shërbimi brenda intervalit kohor prej 1 ore nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqeruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

(iii) Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit. Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë "zgjidhur në mënyrë të tërthortë", (b) tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër, (c) Operatori ekonomik të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose (d) Operatori ekonomik arrin në konkluzion që diagnZXCostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

BNT Electronics do të dokumentojë cdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin e stafit përgjegjës për cdo ndërhyrje.

BNT Electronics të krijojë / diskutojë me Autoritetin Kontraktor dhe perfituesin një axhendë periodike kontrollesh mujore si më poshtë:

1. Javore

- a. Kontroll i statistikave të storage (Used disk space etc)
- b. Kontroll i statistikave për programe
- c. Të kryejë mirëmbajtje proaktive (mirembajtje parandaluese)

2. Mujore.

- a. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve të sistemit software
- b. Rishikim i të dhënave mbi performancë e serverave
- c. Rekomandime për upgrade të mundshme

10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Zhvillimi i sistemit informatik	1		
2.	Trajnime (ne jave)	1		
3.	Mirëmbajtje (ne muaj)	48		
TOTALI PA TVSH (LEKË)				

11. A
F
A
T**I KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT**

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3-M50
1	Faza përgatitore për sistemin	X		
2	Faza e zhvillimit të sistemit software	X	X	
3	Faza e integritit dhe testimit të sistemit software		X	
4	Trajnimi i përdoruesve mbi përdorimin e sistemit		X	
5	Marrja në dorëzim		X	
6	Shërbimi i mirëmbajtjes			X



12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe çdo dokumentacion teknik (mënyrën e konfigurimit të aplikacionit apo pajisjeve, skica, etj.) do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor. Zgjidhja do të dorëzohet e shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar, së bashku me setin e dokumentacionit teknik.

13.KËRKESAT FUNKSIONALE

Sistemi që do të zhvillohet do të përmbajë minimalisht keto kritere teknike:

- Të përshtatet me të gjithë shfletues-at (Mozilla Firefox, Google Chrome, Internet Explorer, Microsoft Edge, Safari, Opera, etj).
- Sistemi do të jetë *scalable* dhe *upgradeable* me rritjen e numrit të përdoruesve ose ndryshimit të përmbajtjes.
- Të jete *web-based* të suportoje numër të lartë përdoruesish njëherësh.
- Të ketë qëndrueshmëri të ndërfaqes së përdoruesëve edhe kur ka shumë përdorues njëkohësisht.
- Duke qenë se sistemi do të lexojë dhe do të ekspozojë një pjesë të të dhënave në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit duhen patur parasysh kërkesat teknike të kësaj platforme.
- Sistemi do të ndërtohet në mënyrë të tillë që të mund të shtohen fusha të tjera në të ardhmen.
- Sistemi do të jetë i ndarë për përdoruesit të cilët do të punojnë me këtë sistem sipas roleve dhe funksioneve që ata do të kenë.
- Sistemi do të ruajë gjurmët e veprimtarisë në sistem për çdo veprim.
- Sistemi do të ndërtohet në konceptin e vendndodhjes parësore dhe vendndodhjes dytësore (BCC). Ndërtimi në këtë koncept do të sigurojë sinkronizim të sistemeve dhe databazave në të dy ambientet në të ardhmen.
- Sistemi do të përdorë një bazë të dhënash të centralizuar për të mbajtur të gjitha të dhënat operacionale. Baza e të dhënave duhet të instalohet në një server të bazës së të dhënave qendrore dhe të gjithë përdoruesit përfundimtarë duhet të aksesojnë të dhënat në një mjedis të tipit web-enabled përmes WEB, LAN ose WAN, pa patur nevojë për të instaluar ndonjë komponent të klientit në PC/Smartphone/Tablet të përdoruesve (arkitekturë Internet i pastër /ndërfaqës klienti zero). Moduli software do të jetë platformë independente.
- Sistemi do të jetë plotësisht i integruar. Të gjitha të dhënat do të regjistrohen vetëm një herë dhe të përdoren kurdo që është e nevojshme në software.
- Sistemi duhet të mbështesë direktori të tilla biznesi LDAP.
- Sistemi do të sigurojë aftësitë e auditimit për të regjistruar të gjitha veprimet e kryera nga të gjithë përdoruesit e fundit.
- Sistemi do të sigurojë autenticitetin dhe sigurinë e të dhënave duke i ruajtur informacionet në bazën e të dhënave në mënyrë të enkriptuar.
- Sistemi do të përdoret lehtësisht, me lundrim logjik dhe informim.
- Sistemi do të përfshijë një strukturë gjithëpërfshirëse të raportimit, për të krijuar raporte ad-hoc, të cilat mund të ekzekutohen menjëherë apo të caktohen në bazë të preferencave të përdoruesit.

- Sistemi do të jetë fleksibël dhe të suportojë volume shumë të mëdha të dhënash.
- Gjatë përdorimit të sistemit, përdoruesi do të ndihmohet me mesazhe ndihmese në varësi të kontekstit.
- Sistemi do të ofrojë të njëjtën ndërfaqe bazë dhe strukturim të informacionit në të gjitha modulet.
- Sistemi do të jetë mjaft fleksibël, për të mundësuar konfigurime ekstra dhe për të shtuar lehtësisht funksionalitete të tjera apo raporte sipas preferencave të AKD-së, në mënyrë që t'i përshtatet nevojave në çdo kohë.
- Për të dhënat që nuk merren automatikisht nga ndërveprimi me sistemet qeveritare do të vendosen manualisht nga punonjësit përgjegjës. Këtu përfshihen edhe të dhënat për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, në ato raste kur do të nevojitet.

13.1. Funksionalitete dhe Bllokskema

Kategoritë/Programet e financimit dhe karakteri i të dhënave të regjistrit:

I. PËRFITUES NGA FONDI I EKSELENCËS

Të dhëna parësore;

- a. Programi i studimit/fusha e studimit
- b. Cikli i studimit.
- c. Kohëzgjatja e programit të studimit.
- d. Viti i Regjistrimit dhe viti i përfundimit të studimeve
- e. Emri i Universitetit.
- f. Vendi/shteti i Universitetit
- g. Viti i fillimit të Financimit
- h. Viti kur përfundon Financimi.

Të dhëna dytësore;

- a) Emri, mbiemri
- b) Atësia
- c) Adresa
- d) Adresa e postës elektronike
- e) Gjinia
- f) Datëlindja
- g) Vendlindja
- h) Nr. Personal

II. PËRFITUES NGA BURSAT E OFRUARA NGA QEVERITËRËT NË VITET TË NDRYSHME, NË KUADËR TË MARRËVESHJEVE DYPALËSHE

Të dhëna parësore;

- a) Programi i studimit/fusha e studimit



- b) *Cikli i studimit.*
- c) *Kohëzgjatja e programit të studimit.*
- d) *Viti i Regjistrimit dhe viti i përfundimit të studimeve*
- e) *Emri i Universitetit.*
- f) *Vendi/shteti i Universitetit*
- g) *Viti i fillimit të Financimit*
- h) *Viti kur përfundon Financimi.*

Të dhëna dytësore;

- a) *Emri, mbiemri*
- b) *Atësia*
- c) *Adresa*
- d) *Adresa e postës elektronike*
- e) *Gjinia*
- f) *Datëlindja*
- g) *Vendlindja*
- h) *Nr. Personal*

III. PËRFITUES NGA PROGRAME TË NDRYSHME NDËRKOMBËTARE**Të dhëna parësore;**

- a) *Emërtimi i programit financues ndërkombëtar*
- b) *Programi i studimit/ fusha e studimit*
- c) *Cikli i studimit.*
- d) *Kohëzgjatja e programit të studimit.*
- e) *Viti i Regjistrimit dhe viti i përfundimit të studimeve*
- f) *Emri i Universitetit.*
- g) *Vendi/shteti i Universitetit*
- h) *Viti i fillimit të Financimit*
- i) *Viti kur përfundon Financimi.*

Të dhëna dytësore;

- a) *Emri, mbiemri*
- b) *Atësia*
- c) *Adresa*
- d) *Adresa e postës elektronike*
- e) *Gjinia*
- f) *Datëlindja*
- g) *Vendlindja*
- h) *Nr. Personal*



IV. TË ARSIMUAR JASHTË VENDIT ME VETËFINANCIM**Të dhëna parësore;**

- a) Programi i studimit/ fusha e studimit
- b) Cikli i studimit.
- c) Kohëzgjatja e programit të studimit.
- d) Viti i Regjistrimit dhe viti i përfundimit të studimeve
- e) Emri i Universitetit.
- f) Vendi/shteti i Universitetit
- g) Viti i fillimit të Financimit
- h) Viti kur përfundon Financimi.


Të dhëna dytësore;

- i) Emri, mbiemri
- j) Atësia
- k) Adresa
- l) Adresa e postës elektronike
- m) Gjinia
- n) Datëlindja
- o) Vendlindja
- p) Nr. Personal

Me poshtë po paraqitet wokflow paraprak i proceseve te punës:

BNT ELECTRONICS





13.2. Raporte Statistike

Sistemi do të ofrojë një hapësirë për gjenerimin e raporteve statistikore të ndryshme.

Disa nga raportet do të përmbajnë:

- Gjenerimi i të dhënave sasiore dhe informacioni lidhur me arsimimin jashtë vendit të shtetasve shqiptar dhe atyre me origjinë shqiptare.
- Numrin dhe tendencat statistikore të shtetasve shqiptarë që përfitojnë mbështetje financiare për realizimin e studimeve jashtë vendit.
- Të dhëna lidhur me tendencën gjeografike/rajonale (BE, USA, etj) të vendeve / institucioneve ku shtetasit shqiptarë mbështeten të realizojnë arsimin e lartë.
- Të dhëna lidhur me tendencën e Programeve të Studimit (fushat e studimit sipas prioriteteve kombëtare), ku shtetasit shqiptarë mbështeten të realizojnë arsimin e lartë.
- Të dhëna lidhur për shpërndarjen gjeografike të personave shqiptar sipas rajoneve/Bashkive.



- Të dhëna lidhur me tendencën e Cikleve të Programeve të Studimit (sipas prioriteteve kombëtare), ku shtetasit shqiptarë mbështeten të realizojnë arsimin e lartë.

Raportet do të mundesohen të eksportohen në formatet excel dhe pdf.


Gjate fazës së analizimit apo gjate mirëmbajtjes mund të lind nevoja për raporte të tjerë, të cilët duhet të realizohen nga operatori ekonomik fitues pa kosto shtese.

14. KËRKESAT TEKNIKE

Sistemi do të instalohet në server virtuale që do të sigurohet nga AKSHI. Serveri do të vihet në dispozicion operatorit fitues në momentin e zhvillimit të sistemit.

BNT Electronics

Jovan Bojdani





"ATLANTIK" sh.a. - SHOQËRI SIGURIMESH

Drejtoria Qendrore: Rr. "Themistokli Gërmenji", nr. 3/1, Tiranë, Tel.: (04) 230 506, Fax.: (04) 235 071
Regjistruar me Vendim Gjykatë nr. 25720, datë 02.05.2001. Leja e KMS datë 01.06.2001. NIPT nr. K11807008V.

061059

Serial _____

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

Ref. _____
Datë 15.02.2021

Për: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), TIRANE

(Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor)

Në emër të: BNT ELECTRONICS, TIRANE

(emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar)

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): Kërkesë për propozime
(Referencat e dosjes nga Autoriteti Kontraktor)

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

(Lloji i procedurës dhe objekti)
Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga republika e Shqipërisë për Agjencinë Kombëtare të Diasporës

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr. _____, datë 0

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që: BNT ELECTRONICS
t'i jetë akorduar kontrata, ne vërtetojmë se BNT ELECTRONICS ka derdhur një depozitë pranë
(emri i ofertuesit të përcaktuar fitues)

Shoqërisë së Sigurimeve "ATLANTIK", sh.a. në shumën prej: 2113440 lekë
(Dy Milion e Një Qindë e Trembëdhjetë Mijë e Katër Qindë e Dyzet Lekë)
(shuma me fjalë)

si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
(Emri autoritetit kontraktor)

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) vlerën e

siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

Lëshuar në DEGA TIRANE, më 15.02.2021 20 _____

SHOQËRIA E SIGURIMEVE "ATLANTIK" sh.a

Përfaqësuesi RANI KOXHAJ/ RANI KOXHAJ-379

(Emri Mbiemër, firma, vula)

Nënshkrimi i kësaj police nënkupton se i siguruari ka disponuar me vullnetin e tij të lirë të gjitha termat dhe kushtet e kontratës së sigurimit.

I siguruari në respekt të ligjit nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr. 220/2014 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", nëpërmjet nënshkrimit të policës së sigurimit jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale nga siguroesi me qëllim përbushjen e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore si dhe transferimin e tyre tek palët e treta.

